



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. të datës 03.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” Sh.P.K. të datës 03.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” (tutje “parashtruesi”) me datë 03.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i tribunës Flamurtari” me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: “Ne, Alko Impex General Construction, kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit për ndërtimin e tribunës së klubit Flamurtari, ku kemi dorëzuar ofertën tonë brenda afatit dhe në përputhje me dokumentet e tenderit. • Autoriteti Kontraktues (AK) ka vendosur për eliminimin tonë nga gara, me arsytim të paqartë dhe pa na dhënë mundësinë për sqarim të dokumentacionit. • Ky vendim përbën shkelje të dispozitave të LPP, Nr. 04/L-042 pasi: 1. AK nuk ka kërkuar sqarime, siç e kërkon Neni 72 i LPP-së”.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për këto arsye:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Nuk keni ofruar dëshmi se keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale.

Ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit ne pikën 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 4 është kërkuar qe:

Kërkesa:

4. Operatori ekonomik duhet te dorëzoj katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Dëshmia:

4. Katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Katalogu qe ju keni dërguar ne ofertën e tuaj nuk përmban kërkesat e kërkuara ne specifikimin teknik te kërkuar nga AK. Ne specifikimin teknik ne pozicionin nr. 12 është kërkuar: Llambe halide metalike me ndezës kuarci 210000 lm ose ekuivalente me 110 lm/w. Grupi i OE ALKO - IMPEX -General Constuction Sh.p.k. ne katalogun e tij ka ofruar llambe halide metalike me ndezës kuarci 180000 lm ose ekuivalente me 85 lm/w.

Sa i përket pretendimeve ankimore është gjetur se nuk është kontestues fakti që në DT është kërkuar Llampë halide metalike me ndezës kuarci 210000 lm ose ekuivalente me 110lm/w. Po ashtu nuk është kontestuar as fakti që parashtruesi ka dorëzuar katalogun mirëpo në katalog mungon specifikimi teknik që është kërkuar nga DT. Më konkretisht parashtruesi ka prezantuar një llampë halide metalike me ndezës kuarci 180000lm ose ekuivalente me 85lm/w. Pra parametrat e llamës me të cilat ka ofertuar parashtruesi janë më të ultë sesa parametrat e kërkuar në DT për pajisjen përkatëse. Sidoqoftë parashtruesi nuk e konteston këtë fakt me kërkesën për rishqyrtim por vetëm pretendon se AK është dashur që përmes sqarimeve shtesë t’i ofroj mundësinë për të sqaruar specifikat teknike sipas katalogut të bashkangjitur. Mirëpo lidhur me këtë pretendim të parashtruesit duhet cekur pikën 10 të UPP ku thuhet si vijon:

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm -	69
--	--	----

Pra sipas UPP nuk lejohet të kërkohen sqarime shtesë në rastin konkret.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.02.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.